

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7129  
E enjte, 29 shkurt 2024  
Çmimi 0.50 €

## Zelensky në Samitin në Tiranë: Humbja e Putinit është siguria jonë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# VARFËRIA, PAPUNËSIA DHE ÇMIMET E ARTIKUJVE, NDËR SHQETËSIMET KRYESORE TË QYTETARËVE



Varfëria, papunësia dhe çmimet për artikuj të domosdoshëm janë ndër problemet më të mëdha që shqetësojnë qytetarët e Kosovës, sipas gjetjeve më të reja të Programit të Kombeve të

Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, të përmbledhur në raportin më të ri të Pulsit Publik. Shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe problemet e hapësirës urbane janë përmendur, po ashtu, si fusha

problematike për qytetarët e Kosovës. Këto gjetje janë përpiluar pas anketimit të 1 306 respondentëve në Kosovë, mbi moshën 18-vjeçare, në periudhën 8-27 nëntor të vitit 2023

**FOL: QEVERIA REALIZOI VETËM 36 % TË AKTIVITETEVE TË PARAPARA TË 2023-s** F.7



**GJYKIMI MARATONIK NË HAGË, TË DHUNUAR NGA GJYKATA E TË PAMBROJTUR NGA SHTETI!** F.6

REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)



## AKTUALE



**NAVALNY DO TË VARROSET TË PREMTEN NË MOSKË** F.2

**EMISARI GJERMAN I TAKON PËRFAQËSUESIT E QEVERISË DHE TË OPOZITËS, TEMË DISKUTIMI ZHVILLIMET E FUNDIT NË KOSOVË** F.6

**PROTESTË KUNDËR KTHIMIT NË RIGJYKIM TË LËNDËS PËR VRASJEN E MARIGONA OSMANIT** F.6


## EKONOMI



**DASH-I: BISEDIMET PËR RREGULLOREN E BQK-së TË VAZHDOJNË URGJENTISHT** F.8

**RICHARD HEATER NGA AMBASADA AMERIKANE VIZITON ATK-në, NJOFTOHET ME PËRPARIMIN** F.8

## SPORT



**KARATEISTJA QË MPOSHTI NË FINALE SERBEN: NDJENJË E MIRË PËR SHKAK TË SË KALUARËS** F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Bideni dhe Trumpi fitojnë lehtësisht zgjedhjet paraprake në Miçigan

WASHINGTON, 28 SHKURT - Presidenti amerikan Joe Biden i ka fituar lehtësisht zgjedhjet paraprake demokratike në Miçigan të martën, mirëpo një votë proteste e demokratëve të zemëruar për mbështetjen e tij për luftën e Izraelit kundër Hamasit në Gazë, i ka tejkaluar pritshmëritë e organizatorëve. Hamasi, grup palestinez që udhëheq Gazën, është shpallur organizatë terroriste prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Ish-presidenti amerikan Donald Trump i ka fituar bindshëm zgjedhjet paraprake republikane në këtë shtet, duke i rritur mundësitë për ta fituar nominimin e partisë së tij për zgjedhjet presidenciale të nëntorit. Ndonëse Bideni dhe Trumpi është pritur të fitojnë lehtësisht në zgjedhjet paraprake në këtë

shtet, procesi i numërimit të votave është vëzhguar prej afër, për ta parë dozën e mbështetjes që ata gëzojnë. Në Miçigan, ku gjendet një komunitet i madh arabo-amerikan, votuesve demokratë u është bërë thirrje t'i plotësojnë fletëvotimet si "të pavendosur", si shenjë proteste për politikën e Bidenit për Gazën. Pas pothuajse gjysmës së votave të numëruara, numri i votuesve "të pavendosur" ka shkuar në mbi 58 000, sipas organizatës Edison Research, duke e tejkaluar shifrën 10 000 që e kishin pritur organizuesit e protestës. Shumë prej pjesëtarëve të komunitetit arabo-amerikan, që e kanë përkrahur Bidenin më 2020, tani janë të zemëruar. Bideni ka thënë më vonë, përmes një deklarate, se



falënderon çdo banor të Miçiganit të cilit i është dëgjuar zëri. "Shfrytëzimi i të drejtës së votës dhe pjesëmarrja në demokraci është çfarë e bën Amerikën të mrekullueshme", ka thënë ai. Sipas Edisonit, Bideni gëzon 80 për qind mbështetje në Miçigan,

ndërsa 13 për qind janë të pavendosur. Pas 58 për qind të votave të numëruara të republikanëve, Trumpi gëzon 67 për qind mbështetje në krahasim me kundërkandidaten e tij Nikki Haley, me 27 për qind. Ky shtet e ofron vazhdimisht

mundësinë e identifikimit të votuesve si "të pavendosur" për ta kuptuar bazën e mbështetjes për një kandidat. Miçigani pritet të luajë rol vendimtar në zgjedhjet presidenciale të 5 nëntorit, kur pritet të përballen kokë më kokë Bideni dhe Trumpi.

## OKB-ja: Një çerek i popullsisë së Gazës është një hap larg urisë

GAZA, 28 SHKURT - Të paktën një çerek i popullsisë së Gazës - 576 000 - persona janë një hap larg urisë, ndonëse edhe pjesa tjetër e popullatës ka nevojë të madhe për ushqim dhe, për pasojë, disa kamionë me ndihma janë plaçkitur prej njerëzve të uritur, kanë thënë zyrtarë të Kombeve të Bashkuara. Punonjës të zyrës së OKB-së për Ndhimë kanë thënë se situata në Gazën me 2.3 milionë banorë është shumë e zymtë dhe ka mundësi që situata të përkeqësohet edhe më shumë. Ata kanë thënë se, përveç çerekut të popullatës që përballet me uri, një në gjashtë fëmijë nën moshën dyvjeçare në veri të Gazës është duke u përballur me "kequshqyerje akute" dhe trupi i tyre po



dobësohet. Carl Skau, zëvendësdirjtor ekzekutiv i Programit Botëror të Ushqimit, ka thënë se ky është "niveli më i keq i kequshqyerjes në gjithë botën".

Ai ka paralajmëruar që "nëse asgjë nuk ndryshon, uria është e pashmangshme në veri të Gazës" - shënjestra e parë në kuadër të ofensivës ushtarake të Izraelit në Gazë pas sulmeve

të Hamasit në jug të Izraelit, më 7 tetor të vitit të kaluar, duke i vrarë rreth 1 200 njerëz dhe duke i marrë 240 pengje. Hamasi, grup palestinez që udhëheq Gazën, është shpallur organizatë terroriste prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Si shembull të prishjes së rendit civil, Skau e ka përmendur se organizata që drejton ai ka rinisur dërgimin e ndihmave në veri të Gazës tri javë më parë. Mirëpo ai ka thënë se përgjatë rrugës, kamionët janë sulmuar me armë zjarri dhe janë plaçkitur. "Në destinacion ata po shohin njerëzit jashtëzakonisht të uritur", ka thënë ai. Për këtë arsye, Skau ka thënë se Programi Botëror i Ushqimit e

ka pezulluar ndihmën atje derisa të ketë kushte për operim të stafit. Zëvendësambasadori izraelit në OKB, Brett Miller, ka thënë se ndonëse ushtria e vendit të tij është duke e luftuar Hamasin, Izraeli po bën "gjithçka që mundet për t'i mbrojtur civilët", dhe është duke punuar vazhdimisht me organizata të ndihmës. Ai e ka akuzuar OKB-në që po refuzon të dërgojë ndihmë në veri të Gazës si dhe disa zyrtarë të OKB-së që, sipas tij, po tentojnë ta fajësojnë Izraelin për situatën e krijuar. Që prej nisjes së ofensivës në Gazë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze, besohet se janë vrarë rreth 30 000 palestinezë.

## Navalny do të varroset të premten në Moskë

MOSKË, 28 SHKURT - Kritiku i ndjerë i Kremlinit, Aleksei Navalny, do të varroset në një varrezë në Moskë të premten, ka konfirmuar një zëdhënës. Shërbimi do të kryhet në varrezën Borisovskoye, pas një ceremonie lamtumirëse që do të mbahet në distriktin Marjino. Të martën zëdhënësja e liderit opozitar ka thënë se ekipi ka hasur në vështirësi për të gjetur një vend për ta mbajtur ceremoninë pasi shumë kompani kanë

refuzuar të përfshihen kur e kanë marrë vesh për këtë bëhet fjalë. Aleksei Navalny ka vdekur në një burg në Arktik gjatë këtij muaji. Për shumë vjet ai ka qenë kritiku i profilit më të lartë kundër presidentit rus Vladimir Putin. E veja e Navalnyt, Yulia, si dhe disa liderë botërorë, e kanë fajësuar Putinin për vdekjen e tij. Ekipi i Navalnyt ka dashur ta organizojë ceremoninë më 29

shkurt, "mirëpo shpejt është bërë e qartë që as edhe një person përreth nuk do të mund ta hapte varrin atë ditë", ka thënë Ivan Zhdanov, drejtor i Fondacionit të Navalnyt Kundër-Korrupsionit në "X". Zhdanov ka thënë se arsyeja është që Putini do ta bëjë adresimin e tij vjetor po atë ditë. "Kremlini e kupton që askush nuk do të merret me Putinin dhe adresimin e tij në ditën e dhënies së lamtumirës për Aleksein", ka



shkruar ai. Zhdanov i ka inkurajuar njerëzit të shkojnë herët në

ceremoni "për të pasur mundësi t'i japin lamtumirën Alekseit".



REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

# Gjykimi maratonik në Hagë, të dhunuar nga gjykata e të pambrojtur nga shteti!



Jemi në vitin e katërt kur udhëheqësit kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe udhëheqësit më të lartë të institucioneve të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli si dhe shefi i GP të VV-së, Rexhep Selimi po mbahen të paraburgosur si pengje politike në Njësinë e Paraburgimit të Gjykatës Raciste në Hagë, pa një datë dhe vit të caktuar se kur do të përfundojë gjykimi. Këtë e tha në një intervistë edhe Ekaterina Trandafilova, kryetare e kësaj Gjykate që i lutet Zotit që kjo të zgjasë sa më shumë për shkak të përfitimeve marramendëse materiale për të dhe shpurën e burokratëve endacakë që shkojnë në çdo vend ku ka pasur krizë për ta vazhduar vallen e zhvatjeve në kurriz të viktimave dhe të të akuzuarve. Deri më tani janë dëgjuar 44 dëshmitarë të Prokurorisë Speciale Raciste, pjesa më e madhe e tyre janë serbë të aparatit policor dhe ushtarak të Serbisë apo edhe shqiptarë që janë rekrutuar dhe trajnuar nga siguri serb për të dëshmuar kundër të akuzuarve e që tani janë duke u gjykuar. Këta dëshmitarë, tashmë të "mbrojtur" kanë dëshmuar edhe në Kosovë sikur që kanë pasur paraqitje të rregullta publike. Proceset para GJSR janë kryesisht të mbyllura me ç'rast shkulet rëndë parimi i publicitetit, sa i rëndësishëm aq edhe i nevojshëm që përmes një gjykimi transparent të bindet dhe

sigurohet publiku se dëshmitë janë të sakta pas së cilave edhe vendimi gjyqësor do të ishte shumë më i besueshëm. Ekaterina Trandafilova, një kuadër i Todor Zhivkovit, në jo pak raste ka shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë duke deklaruar se të akuzuarit mund të dënohen edhe me burg të përjetshëm pa hasur në asnjë kundërshtim të institucioneve të vendit dhe komisioneve parlamentare që kanë mandat të mbrojnë të drejtat e njeriut. Në të njëjtën kohë në Kosovë "avokatë" të dënuar për dhunim dhe veprime skajshmërisht të pamoralshme gjithashtu shkelin parimin e prezumimit të pafajësisë duke deklaruar në media se të akuzuarit që tani janë duke u gjykuar duhet të dënohen jo më pak se nga 40 vjet burg! Në rrethana normale Oda e Avokatëve e Kosovës do të duhej të ndërmerre masa për shkelje të Etikës por pasi këtu kemi të bëjmë me njerëz pa kurrfarë morali apo etike dhe pa kurrfarë integriteti profesional dhe njerëzor, ndaj tyre duhet të ndërmerren masa të tjera. Madje, duhet të hetohet rasti se si e kanë fituar licencën e avokatit. Kanë mbetur të merren në pyetje edhe së paku 100 dëshmitarë të ZPS-së në Hagë dhe, nëse shkohet me dinamikën e tashme do të duheshin edhe tre (3) vite që të përfundojnë dëshminë këta dëshmitarë pastaj duhet të dëgjohen edhe dëshmitarët e palës mbrojtëse që nënkupton se vetëm dëshmitarët do të marrin 4

deri 5 vjet e ardhshme që është non sense për faktin se, që nga Procesi i Njereburgut dhe proceset e tjera të ngjashme në Gjykatën për ish jugosllavi në Hagë, në Arusha të Tanzanisë, Liban, Siera Leone dhe vendet tjera ku ka pasur shkelje masive të së drejtës humanitare dhe krime të luftës me miliona të vrarë, gjykimet kanë qenë shumë më të shpejta sikur që edhe vendimi gjyqësor është marrë brenda një afati të arsyeshëm e që nuk është në kundërshtim me Deklaratën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Se si po zhvillohen ngjarjet vetëm dëgjimi i dëshmitarëve do t'i marrë, së paku 8 vite që nënkupton se të akuzuarit për aq kohë do të qëndrojnë në paraburgim që tejkalon çdo afat normal të një gjykimi të arsyeshëm dhe paraqet shkelje flagrante të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të personave të privuar nga liria, në veçanti. Është e pabesueshme dhe pa asnjë kuptim logjik që Kuvendi i Kosovës përkatësisht deputetët e këtij Kuvendi që thonë se janë themelues të kësaj gjykate sikur që edhe kjo Gjykatë thirret në ligjet e Kosovës ndonëse me asgjë nuk i detyrohet Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve të vendit, nuk kanë guxim që në një seancë apo më shumë seanca parlamentare të diskutojnë për shkeljet flagrante që iu bëhen personaliteteve më të larta ushtarake dhe politike, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. Diskutimi për shkelje të

drejtave të njeriut në asnjë mënyrë nuk duhet dhe nuk mund të kuptohet si ndërhyrje në drejtësi por se mungon vullneti dhe guximi të trajtohet kjo temë. Se pozita që është në pushtet nuk ka asnjë interesim të kërkojë informata dhe sqarime për pengjet e Hagës, nuk është vështirë të kuptohet sepse shteti po bënë të gjithë atë që mundet për t'ua bërë më të vështirë jetën dhe mbrojtjen e tyre qoftë duke ua shkurtuar mundësinë për mbajtje ligjore përmes heqjes së fondeve apo zbatimit selektiv të Ligjit, qoftë përmes deklaratave publike dhe mënyrave tjera (dërgimi i materialeve siç pati deklaruar në media një politikane e lartë) sikur edhe përmes dëshmitarëve të mbrojtur për çka edhe janë arrestuar persona në Kosovë dhe Shqipëri pasi këtë e kanë thënë publikisht. KMDLNj denoncon publikisht edhe mungesën e reagimit të organizatave që kanë ekskluzivitet në monitorim në këtë Burg si Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në Gjenevë, Avokati i Popullit i Holandës dhe, mendermethënë Avokati i Popullit i Gjykatës Speciale. Komiteti për Parandalim të Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor, sipas mandatit i takon t'i vizitojë të burgosurit e Hagës për faktin se ata e kanë këtë mandat në tërë botën. Se si kanë shkuar gjërat deri më tani, KMDLNj me asgjë nuk bindet se të arrestuarit kanë të

drejtë për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar nga politika dhe grupet e interesit të cilën e garantojnë të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ka dyshime përtej të së arsyeshmës e ish prokurori Jack Smith ka qenë i përfshirë në afëra korruptive për këtë proces sikur që ZPS ka lejuar rrjedhjen e qëllimshme të dokumenteve të ndjeshme pas së cilave janë arrestuar dhe dënuar me dënime kapitale drejtues të Shoqatës së Vetranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Për këtë asnjëherë nuk ka pasur hetime dhe askush nuk ka dhënë përgjegjësi përveç hallkës së fundit që i nënshtrohej përgjegjësisë e që u dënuan nga kjo Gjykatë, Gucati dhe Haradinaj. Për ta siguruar vazhdimësinë e këtij biznesi shumë fitimprurës për Ekaterina Trandafilovën dhe shpurën e saj burokratike, është sajuar një cilësim juridik si pengimi i drejtësisë në emër të së cilës janë kryer qindra bastisje në Kosovë, janë konfiskuar telefona dhe PC sikur edhe libra, publikime, albume fotografike dhe të tjera dhe janë arrestuar persona të shumtë. Nuk mbahet mend ndonjë proces gjyqësor i kësaj natyre që po zgjatë aq shumë, që ka transparencë nën çdo minimum dhe ku shteti është kundër të akuzuarve të cilët edhe mund të llogariten se janë Etërit Themeltar të Lirisë, Pavarësisë dhe Shtetit të Kosovës.





# Varfëria, papunësia dhe çmimet e artikujve, ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve

Varfëria, papunësia dhe çmimet për artikuj të domosdoshëm janë ndër problemet më të mëdha që shqetësojnë qytetarët e Kosovës, sipas gjetjeve më të reja të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, të përmbledhur në raportin më të ri të Pulsit Publik. Shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe problemet e hapësirës urbane janë përmendur, po ashtu, si fusha problematike për qytetarët e Kosovës. Këto gjetje janë përpiluar pas anketimit të 1 306 respondentëve në Kosovë, mbi moshën 18-vjeçare, në periudhën 8-27 nëntor të vitit 2023

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka publikuar të mërkurën edicionin e 25-të të Përmbledhjes së Pulsit Publik. Anketa e opinionit e Pulsit Publik nxjerr në pah perceptimet e njerëzve për çështjet socio-ekonomike, politike, të sigurisë dhe mjedisit. Përmbledhja e Pulsit Publik 25 bazohet në të dhënat e mbledhura nga 8 nëntori deri më 27 nëntor 2023 dhe pasqyron opinionin e më shumë se 1 300 të anketuarve të moshës mbi 18 vjeç. Të dhënat e mbledhura përmes kësaj ankete zërthehen sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike për të ofruar informacion mbi dallimet e mundshme në perceptimet e qytetarëve për çështje të ndryshme zhvillimore në Kosovë. Sipas anketës, të dhënat tregojnë se mesatarisht 42.44 % e të

anketuarve janë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës. Kënaqshmëria me punën e kabinetit ekzekutiv është shënuar 41.8 %, ndërsa kënaqshmëria me punën e kryeministrit është shënuar 48.9 %. Kënaqshmëria me Kuvendin ishte 38.7 %, ndërsa kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit ishte 52.2 %. Kënaqshmëria me presidenten është regjistruar në 56.2 %. Ndërkaq shkalla e kënaqshmërisë ishte 29.3 % ndaj gjykatave dhe 30 % ndaj Prokurorisë. Tre çështjet kryesore më të raportuara gjatë kësaj ankete ishin varfëria (28.6 %), papunësia (19.2 %) dhe çmimet për artikuj të domosdoshëm (8.9 %). Shërbimet e kujdesit shëndetësor (8 %) dhe problemet e hapësirës urbane (3.8 %) ishin ndër pesë problemet kryesore të

identifikuara. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan se varfëria u renditet si problemi kryesor për shqiptarët e Kosovës (28.6 %) dhe komunitetet e tjera të Kosovës (29.5 %), ndërsa problemet e hapësirës urbane (19.5 %) u renditën si problemi kryesor për serbët e Kosovës. Teksa papunësia ishte çështja e dytë më urgjente për 20.2 % të shqiptarëve të Kosovës dhe 13.8 % të serbëve të Kosovës, energjia elektrike u rendit e dyta për 14.5 % të komuniteteve të tjera të Kosovës. Sipas kësaj ankete, gjetjet treguan një rënie në ndjenjën e sigurisë në mesin e të anketuarve me 79.73 % që ndiheshin të sigurt kur ishin jashtë në rrugë. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë treguan se më shumë meshkuj (80 %) sesa femra (78.9 %) deklaruan se ndihen të sigurt kur janë jashtë. "37.6 % e serbëve të Kosovës deklaruan se ndihen të sigurt kur janë jashtë në rrugë

(6.2 % deklaruan se ndihen shumë të sigurt, ndërsa 31.4 % deri diku të sigurt). 80.8 % e shqiptarëve të Kosovës raportuan se ndihen të sigurt (me 25.1 % që ndiheshin shumë të sigurt dhe 55.7 % ndiheshin deri-diku të sigurt). Sa iu përket komuniteteve të tjera të Kosovës, 80 % kanë raportuar se ndiheshin të sigurt (me 12.5 % që ndiheshin shumë të sigurt dhe 67.5% ndiheshin deri-diku të sigurt)", thuhet në përmbledhjen e Pulsit Publik. Anketa e opinionit e Pulsit Publik e nëntorit 2023, regjistroi një rritje të lehtë në Indeksin e Demokratizimit (DI) dhe një rritje në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (ECI). Më konkretisht DI-ja aktuale është rritur me 0.01 pikë në 1.49, ndërsa TKE është rritur me 0.15 pikë në 1.18. Një rritje pozitive në perceptimin e njerëzve për drejtimin ekonomik është vërejtur në anketën e opinionit të nëntorit 2023. Gjithsej 20.23 % ishin shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik drejt të cilit po shkon Kosova aktualisht. Ndryshimet më të mëdha sa i përket perceptimit të korrupsionit në shkallë të gjerë janë vërejtur në institucionet në vijim: Policia e Kosovës (nga 7.3 % në 17.9 %) dhe komunat (nga 15.8 % në 21.7 %). Një rënie pozitive në perceptimin e

korupsionit në shkallë të gjerë është vërejtur në gjykata (nga 37.7 % në 28.8 %). 63.7 % e të anketuarve kanë theksuar se informacioni përmes medieve është se si ata e vlerësojnë praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në Kosovë, ndërsa gjithsej 30.5 % e të anketuarve kanë deklaruar se bisedat me të afërmit dhe miqtë kanë formuar bazën e opinionit të tyre lidhur me shtrirjen e korrupsionit. Vetëm 5.5 % e të anketuarve pohuan se përvojat personale formësuan perceptimin e tyre për korrupsionin në shkallë të gjerë. Të anketuarit u pyetën për gjasat për të votuar nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti. Gjithsej 72.8 % e të anketuarve pohuan se do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti. Të dhënat e anketës të opinionit të nëntorit 2023 treguan se 59.3 % e shqiptarëve të Kosovës dhe 32.4 % e serbëve të Kosovës besonin (plotësisht ose disi) se marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës, ndërsa 62.5 % e komuniteteve tjera të Kosovës besonin (plotësisht ose disi) se marrëveshja do të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës.



# Zelensky në Samitin në Tiranë: Humbja e Putinit është siguria jonë

TIRANË, 28 SHKURT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se udhëheqësi rus Vladimir Putin po përdor diktate të së shkuarës për të bërë që shtetet të veprojnë siç do ai.

Gjatë samitit "Ukrainë - Evropa Juglindore", që u mbajt në Tiranë të Shqipërisë, Zelensky tha se Evropa duhet të jetë hapësira ku çdo shtet përcakton fatin e vet. "Ne kemi parë në të kaluarën që ka pasur njerëz që janë përpjekur për ta përcaktuar fatin e kombeve të tjera. Kjo ka ndodhur në Ballkan, Evropën lindore dhe pjesë të tjera të Evropës. Tani Putini dëshiron ta bëjë këtë. E gjithë armiqësia e tij, gjithçka që ai bën, është për t'i detyruar kombet e tjera të bëjnë siç do ai. Prandaj është e rëndësishme për të gjitha shtetet tona që Putini, regjimi i tij, të humbasë, sepse dështimet e tij janë siguria jonë e përbashkët", tha ai.

Udhëheqësi ukrainas falënderoi shtetet e Evropës juglindore për ndihmën e ofruar për shtetin e tij në luftë, por edhe në integrimin evropian. Ai tha se të gjitha shtetet në rajon, që ndajnë vlera evropiane, duhet të integrohen.

Ai tha se të gjitha shtetet në rajon, që kultivojnë vlerat evropiane, duhet të integrohen në "BE-ja dhe NATO-ja i kanë ofruar Evropës epokën më të gjatë dhe më të fortë të sigurisë, paqes dhe zhvillimit ekonomik dhe ne meritojmë që në fund të jemi pjesë e komunitetit evropian dhe euroatlantik", tha ai.

Duke folur për mbrojtjen, Zelensky tha se është i interesuar ta rrisë bashkëpunimin me shtetet e Ballkanit Perëndimor, veçmas në fushën e bashkëpunimit të



## Rama dhe Zelensky me traktat miqësie

Zelensky është takuar me Ramën në Tiranë. Pas takimit mes kryeministrit shqiptar dhe presidentit ukrainas, u takuan edhe delegacionet e të dyja shteteve. Takimet u përmbyllën me nënshkrimin nga Rama dhe Zelensky të Traktatit të miqësisë dhe bashkëpunimit mes dy shteteve. "Traktati i shërben konsolidimit të miqësinë mes dy vendeve dhe

popujve, përmes zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme me interes të ndërsjellë", u tha në një njoftim nga qeveria shqiptare. Udhëheqësi ukrainas ka mbërritur në Tiranë pak para mesnatës, sipas ministrit shqiptar për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani. Kjo është vizita e parë e Zelenskyt në Tiranë, e cila

municioneve. "Ne shohim se problemet me municion po ndikojnë në situatën në fushëbetëje [në Ukrainë]. Ne jemi të interesuar për bashkëpunim tek ju dhe me të gjithë partnerët e tjerë. Ekipi ynë qeveritar do të paraqesë detajet për mbajtjen e një forumi të industrisë së mbrojtjes së Ukrainës dhe Ballkanit në Kiev, apo në ndonjë nga kryeqytetet tuaja", tha ai.

Në fjalën hyrëse, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, u bëri thirrje shteteve demokratike të rajonit, por edhe atyre më të pasura, që të vazhdojnë ta mbështesin financiarisht dhe ushtarakisht Ukrainën sepse, sipas tij, prej kësaj mbështetje varet mbijetesja e Ukrainës. "Mënyra për t'i dhënë fund luftës nuk është çarmatosja e viktimës për ndaljen e agresorit.

Shpërblimi i një agresori që pushton territorin e një shteti sovran nuk sjell paqe, por hap rrugën për më shumë luftë", tha Rama.

Rama tha se Putini nisin luftën e paprovokuar ndaj Ukrainës në shkurtin e vitit 2022, sepse ai ishte "i drejtuar nga një ëndërr e vjetër e një të shkuare perandorake". "Prania juaj këtu është përkujtues se ai ka dështuar, pavarësisht

fuqisë ushtarake dhe prej propagandës toksike, Rusia neoimperialiste ka dështuar ta shtypë qeverinë ukrainase të zgjedhur në mënyrë demokratike. Ka dështuar ta shtypë vullnetin e ukrainasve që të jetojnë në një shtet të lirë, të pavarur dhe demokratik. Ka dështuar që të heshtë të vërtetën", tha Rama.

Në samitin në Tiranë liderët do të diskutojnë për çështje të sigurisë dhe për mbështetjen e Kievit në luftën e tij kundër pushtimit rus. Samiti po mbahet me ftesë të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, dhe në të po merr pjesë edhe presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky.

Në samit po marrin pjesë edhe udhëheqës të Ballkanit Perëndimor.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, para nisjes së samitit, tha se në të do të flasë për hapat konkretë që po ndërmerren shteti për ta mbështetur Ukrainën.

Ajo u pyet se nëse do të kërkojë nga presidenti Zelensky që të anjohë pavarësinë e Kosovës. "Këto janë çështje bilaterale. Ne gjithnjë e kemi bërë një kërkesë të tillë. Do të vazhdojmë ta bëjmë me mirëkuptimin e plotë që Ukraina është në gjendje të jashtëzakonshme, në gjendje lufte, duke luftuar për liri", tha Osmani. "Jam e bindur që ai moment do të vijë bashkë me fitoren e Ukrainës", shtoi ajo.

Ndërkaq presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, para nisjes së samitit tha për gazetarët se ai ka disa propozime për deklaratën që pritet të dalë nga ky samit, por nuk iu përgjigj pyetjes së gazetarëve nëse Serbia planifikon të vendosë sanksione kundër Rusisë.





## Emisari gjerman i takon përfaqësuesit e qeverisë dhe të opozitës, temë diskutimi zhvillimet e fundit në Kosovë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 28 shkurt - Emisari i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, ka takuar të martën dhe të mërkurën në Prishtinë përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësues të partive opozitare. Zëvendëskryeministri i Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, gjatë takimit me Sarrazin, ka thënë se Republika e Kosovës e çmon dhe vlerëson lart partneritetin, bashkëpunimin dhe miqësinë e ngushtë me Gjermaninë. Sipas njoftimit të qeverisë, palët diskutuan mbi situatën në vend dhe rajon dhe zhvillimet e fundit politike. Një prej temave të adresuara ishte edhe masat ndëshkuese ndaj Kosovës, ku zëvendëskryeministri Bislimi theksoi se ato vijnë të jenë të padrejta dhe se duhet të hiqen sa më parë. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi emisarin Sarrazin për



përkushtimin, angazhimin e tij të vazhdueshëm e intensiv dhe për këtë vizitë të radhës në vendin tonë. Edhe kryetari i Partisë

Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka pritur në takim të dërguarin special të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin. "Zhvillimet

politike në vend dhe rajon ishin tema të diskutimit tonë, për të cilat shkëmbyem qëndrimet tona. Për PDK-në, përtej papërgjegjësive së Qeverisë së Kosovës, është tejet e

rëndësishme që Bashkimi Evropian të heqë sanksionet ndaj Kosovës, nga të cilat po vuajnë më së shumti qytetarët tanë. PDK, si përherë, me bashkëpunim dhe përgjegjësi, do të angazhohet të ruajë interesin e shtetit, të qytetarëve dhe perspektivën e saj evropiane", ka njoftuar Krasniqi pas takimit. Sarrazi është takuar edhe me kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku. Në këtë takim Abdixhiku dhe emisari Sarrazin diskutuan rreth situatës aktuale politike në Kosovë si dhe qëndrimeve të LDK-së lidhur me këto tema. Kryetari Abdixhiku e falënderoi Sarrazin për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania i ka dhënë Kosovës në të gjitha proceset, në veçanti në procesin e liberalizimit të vizave. Abdixhiku, po ashtu, ritheksoi se LDK-ja mbetet e përkushtuar dhe gjithmonë e gatshme për bashkëpunim me aleatët ndërkombëtarë në proceset e rëndësishme të Kosovës.

## Protestë kundër kthimit në rigjykim të lëndës për vrasjen e Marigona Osmanit

PRISHTINË, 28 SHKURT - Pjesëtarë të Kolektivit për Mendim dhe Veprim Feminist kanë protestuar të mërkurën para Pallatit të Drejtësisë në Prishtinë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për ta dërguar në rigjykim lëndën e vrasjes së Marigona Osmanit. Bjeshkë Guri, përfaqësuese e organizatës, ka thënë se janë mbledhur para Gjykatës së Apelit për t'i "kundërshtuar praktikat e sistemit të drejtësisë në Kosovë, i cili është duke na vërtetuar çdoherë e më shumë se nuk është duke funksionuar për gratë, duke ua pamundësuar çfarëdo lloj drejtësie". Ajo ka thënë se vendimi i gjykatës për rastin e Osmanit ka shkaktuar "revoltim tej mase" dhe rrezikon sigurinë e grave dhe vajzave në Kosovë. "Nuk mund të lejojmë që rasti i Marigonës të zvarritet në ndërtesat e gjykatave dhe



eventualisht t'ua thellojë edhe më tej dhimbjen familjarëve të saj", ka thënë ajo. Në gusht të vitit 2023, Dardan Krivaqa është dënuar me burgim të përjetshëm për vrasjen e Osmanit, ndërsa Arbër

Sejdiu është dënuar me 15 vjet burgim për ndihmë në kryerjen e veprës "vrasje e rëndë". Pjesëmarrësit në protestë janë parë duke mbajtur mbishkrimet "Ne nuk harrojmë", "Drejtësi për Marigonën", "Siguri dhe drejtësi

për gratë" e tjera. Më 23 shkurt, Apeli ka miratuar ankesat e avokatëve mbrojtës për aktgjykimin, me arsyetimin se ka pasur shkelje procedurale gjatë gjyqimit. Të akuzuarit do të vazhdojnë të

qëndrojnë në paraburgim. Marigona Osmani ka qenë 18-vjeçare kur është vrarë, më 22 gusht të vitit 2021, në banesën e të akuzuarit kryesor, Dardan Krivaqa, në qytetin e Ferizajit. Krivaqa e Sejdiu e kanë dërguar trupin e pajetë të viktimës në spitalin e qytetit dhe më pas janë larguar në drejtim të panjohur. Sipas aktakuzës, Krivaqa, më 21 gusht 2021, rreth orës 10:14, në banesën e tij, pa pëlqimin e tani të ndjerës Marigona Osmani, e ka detyruar atë të kryente marrëdhënie seksuale dhe e kishte abuzuar e maltretuar në forma të ndryshme. Sipas aktakuzës, një ditë më pas, më 22 gusht 2021, Krivaqa dhe Sejdiu e kanë vrarë të ndjerën në përpjekje për ta fshehur veprën penale të dhunimit. Ata janë akuzuar edhe për kryeje të dhunimit, por janë shpallur të pafajshëm në këtë pikë në mungesë provash.

## Krasniqi në Likoshan dhe Çirez nderon martirët dhe dëshmorët

PRISHTINË, 28 SHKURT - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka qëndruar të mërkurën në Likoshan dhe Çirez, për t'nderuar martirët dhe dëshmorët e UÇK-së të kësaj

ane, të cilët 26 vjet më parë, përmes guximit, sakrificës dhe gjakut të tyre, u bënë dritë për lirinë e Kosovës. "Lavdi e përjetshme!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".





# FOL: Qeveria realizoi vetëm 36 % të aktiviteteve të parapara të 2023-s

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË 28 SHKURT - Lëvizjes FOL ka mbajtur të mërkurën konferencë për medie, në të cilën ka publikuar të dhënat nga monitorimi i planit vjetor të punës së qeverisë, tashmë i quajtur Plani Kombëtar për Zhvillim.

Burbuqe Kastrati, menaxhere e projektit në Lëvizjen FOL, tha se edhe këtë vit FOL ka bërë monitorimin e aktiviteteve të parapara në Planin Kombëtar për Zhvillim. "Qeveria e Kosovës nga 655 aktivitete të parapara të realizohen brenda periudhës janar-dhjetor 2023 ka arritur të realizojë vetëm 234 apo 36 %, nuk i ka realizuar 151 apo 23 % dhe nuk ka kthyer përgjigje për 270 aktivitete apo 41 %", ka thënë Kastrati, duke shtuar se numrin e madh të aktiviteteve pa përgjigje e kanë shtuar edhe tri ministrinë që nuk janë përgjigjur fare e që kanë pasur një numër të madh të aktiviteteve të parapara.

Kastrati ka theksuar se Zyra e Kryeministrit, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nuk janë përgjigjur fare në pyetësonin e dërguar nga ne dhe, gjithashtu, një numër i madh i ministrive kanë lënë pyetje pa përgjigje.

Gjithashtu, Kastrati ka shpjeguar se të gjitha aktivitetet e parapara të përfundojnë brenda periudhës janar - dhjetor 2023 përmes pyetësorëve u janë dërguar sekretarëve të përgjithshëm të ministrive. Sipas saj, të dhënat e prezantuara janë të dhëna të marra direkt nga personat përgjegjës për realizimin e këtyre aktiviteteve. Ndërkaq Viona Bunjaku, monitoruese në Lëvizjen FOL, ka paraqitur të dhënat për secilin ministri sa i përket realizimit të aktiviteteve të parapara të përfundojnë brenda vitit 2023.

## Zyra e Kryeministrit

ZKM kishte paraparë 74 aktivitete të realizohen gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, mirëpo nuk ka kthyer asnjë përgjigje për realizimin e tyre. Në lidhje me këtë, FOL ka dërguar ankesë në AIP dhe presim afatet ligjore që të kemi të dhëna për realizimin apo jo të këtyre aktiviteteve.

## 1. Ministria për Komunitete dhe Kthim

MKK për periudhën janar - dhjetor 2023 ka paraparë realizimin e 4 aktiviteteve prej të cilave ka realizuar vetëm 2, ndërkaq 1 aktivitetet nuk është përfunduar dhe për realizimin e 1 aktiviteti nuk kanë kthyer përgjigje.

## 2. Ministria e Shëndetësisë

MSH në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 32 aktivitetet brenda periudhës janar - dhjetor 2023, prej të cilave 14 i ka realizuar, 14 nuk i kanë realizuar dhe për 4 aktivitete nuk kanë kthyer përgjigje.

## 3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MKRS në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të realizojë 41 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Përgjigje kemi marrë vetëm për 1 aktivitet të realizuar, 1 të përfunduar dhe për 39 aktivitete të tjera nuk kemi pranuar përgjigje.

## 4. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MBPZHR në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 22 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Prej tyre kanë realizuar 10 ndërkaq 9 janë të përfunduar dhe 3 janë pa përgjigje. Vlen të theksohet se kjo ministri ka dërguar përgjigje edhe për 24 aktivitete tjera realizimi i të cilave shtrihet



përtej vitit 2023, dhe 6 aktivitete të tjera të cilat nuk ishin pjesë e PKZH-së.

## 5. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MFPT në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor ka paraparë të përfundojë 32 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Vetëm 23 janë përfunduar brenda afatit të parapara ndërkaq 8 janë të pa realizuara dhe 1 është pa përgjigje.

## 6. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

MMPHI në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor ka paraparë të përfundojë 61 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Vetëm 7 janë përfunduar brenda afatit të parapara ndërkaq 6 janë të përfunduar, ndërkaq 48 janë pa përgjigje.

## 7. Ministria e Drejtësisë

MD në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 77 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Vetëm 43 janë përfunduar brenda afatit të parapara ndërkaq 31 janë të përfunduar dhe 3 janë pa përgjigje.

## 8. Ministria e Zhvillimit Rajonal

MZHR nuk ka paraparë asnjë aktivitet, realizimi i të cilave fillon në janar dhe përfundon në dhjetor 2023.

## 9. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

MASHTI në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 32 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023, prej të cilave ka realizuar 16 dhe 16 të tjera janë të përfunduar.

## 10. Ministria e Ekonomisë

ME në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 25 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Vetëm 14 janë përfunduar brenda afatit të parapara ndërkaq 9 janë të përfunduar dhe 2 janë përgjigje.

## 11. Ministria e Punëve të Brendshme

MPB në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, ka paraparë të përfundojë 93 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Vetëm 46 janë përfunduar brenda afatit të parapara ndërkaq 43 janë të përfunduar dhe 4 janë pa përgjigje.

## 12. Ministria e Mbrojtjes

MM nga 9 aktivitete të parapara të realizohen gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, nuk ka kthyer përgjigje. Andaj nuk dihet se sa prej tyre janë realizuar dhe sa jo.

## 13. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MINT nga 80 aktivitete të parapara të realizohen gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, nuk ka kthyer përgjigje. Andaj nuk dihet se sa prej tyre janë realizuar dhe sa jo.

## 14. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MPJD në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 15 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Prej tyre 9 prej tyre janë të realizuara, 5 të pa realizuara dhe 1 pa përgjigje.

## 15. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

MPJD në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojë 58 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2023. Prej tyre 49 prej tyre janë të realizuara, 8 të pa realizuara dhe 1 pa përgjigje.

Sipas Bunjakut, ajo çka duhet theksuar është se shumë nga ministrinë kanë dërguar dhe informacione shtesë sa i përket realizimit të planit, mirëpo FOL ka bërë monitorimin e aktiviteteve të parapara të përfundojnë gjatë vitit 2023 dhe jo ato që kanë filluar në vitin 2023 dhe janë parapara të përfundojnë përgjatë tri viteve pra deri në vitin 2025.

Monitorimin e zbatimit të planit të punës së qeverisë, Lëvizja FOL e ka bërë edhe në vitet e kaluara. Në vitin 2022 niveli i zbatimit të Planit të Punës së Qeverisë ka rezultuar të jetë 49 %, ndërsa në vitin 2021 realizimi i Planit të Punës së Qeverisë ishte 56 %.

# Konjufca pret në takim anëtarët e Komisionit të Mbrojtjes të Bundestagut gjerman, i falënderon për mbështetjen



PRISHTINË, 28 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim anëtarët e Komisionit të Mbrojtjes të Bundestagut gjerman, bashkë me kryetaren e këtij komisioni, Marie-Agnes Strack-Zimmermann.

Konjufca shprehu mirënjohje për kontributin e gjatë dhe të vyer të shtetit gjerman ndaj Republikës së Kosovës. Ai i falënderoi anëtarët e Komisionit për angazhimin në drejtim të forcimit të bashkëpunimit mes vendeve tona në fushën e parlamentarizmit, të sigurisë dhe mbrojtjes. Ai tha se vendet

tona mike dhe partnere ndajnë ngushtësisht interesa të përbashkëta, "e kjo mundëson të hapim gjithnjë e më shumë gamën e raporteve dhe forcimin e tyre".

Anëtarët e Komisionit gjerman të Mbrojtjes thanë se mbështetja gjermane ndaj vendit tonë do të vijojë, përfshirë edhe në drejtim të ruajtjes së integritetit, sovranitetit dhe sigurisë së Kosovës, si kontribut edhe për stabilitetin rajonal.

Kryetaren dhe anëtarët e Komisionit të Mbrojtjes gjermane, Konjufca i njoftoi me

punën e Kuvendit të Kosovës në çështjet e mbrojtjes, në anën tjetër i njoftoi edhe me zhvillimet në vendin tonë, ku vlerësoi lart praninë e shtuar gjermane në Kosovë me trupat e angazhuara në kuadër të KFOR-it dhe rëndësinë e kësaj në një kohë kur shteti serb angazhohet për destabilizim të vendit tonë dhe rajonit.

Anëtarët e Komisionit e falënderuan kryetarin e Kuvendit për mikpritjen dhe shprehjen gatishmërinë e tyre për zhvillimin e angazhimeve të përbashkëta në kuadër të interesave të dyanshme.



## DASH-i: Bisedimet për rregulloren e BQK-së të vazhdojnë urgjentisht

PRISHTINË, 28 SHKURT - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) tha se bisedimet në Bruksel për rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), që ndalon përdorimin e dinarit serb në Kosovë, "duhet të vazhdojnë urgjentisht". "Dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian është kanali i duhur për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë", tha një zëdhënës i DASH-it pasi u pyet nga "Radio Evropa e Lirë" për bisedimet që u zhvilluan të martën për çështjen e rregullores.

Ndërmjetësuesi i tyre, i dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, tha se shumë pikëpyetje politike për çështjen e dinarit serb në Kosovë mbetën pa përgjigje, andaj "duhen takime shtesë".

Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, i cili udhëhoqi delegacionin e Kosovës, tha se nuk u diskutua për rregulloren, porse



për mundësitë që i ofron ajo për transferimin e mjeteve nga shtetet e tjera në Kosovë.

Delegacionin e Serbisë e udhëhoqi kryenegociatori Petar Petković, i cili tha se rregullorja e

BQK-së kërkon zgjidhje në nivel politik.

Bisedimet pasuan fuqizimin e kësaj rregulloreje, e cila e përcakton euron si valutën e vetme që mund të përdoret për

pagesa të gatshme në Kosovë. Por, rregullorja nxiti reagime të zemëruara të Beogradit zyrtar, i cili mbështet financiarisht komunitetin serb në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare

shprehu, po ashtu, shqetësime për ndikimin e saj në jetën e qytetarëve serbë dhe kërkoi pezullimin e saj.

Ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, tha se vendimi për dinarin i ka vënë në pikëpyetje marrëdhëniet Kosovë - ShBA. "Shtetet e Bashkuara kanë qenë të qarta në shprehjen e shqetësimeve për rregulloren e re", tha zëdhënësi i DASH-it për "REL"-in.

Ai tha se përsërit thirrjet për Kosovën dhe Serbinë që t'i ulin tensionet dhe të angazhohen "seriozisht dhe urgjentisht" "për të arritur një marrëdhënie paqësore dhe produktive në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja". Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, këmbëngul se vendimi i BQK-së nuk mund të anulohet. Sipas tij, rregullorja nuk i ndalon pagesat nga buxheti i Serbisë, por se ato duhet të bëhen në euro. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, thotë se qëllimi i Kurtit është "spastrimi etnik i popullit serb nga Kosova".

## Sekretarja e Ministrisë së Bujqësisë në Uashington adreson sfidat dhe arritjet në implementimin e projektit MAP16

PRISHTINË, 28 SHKURT - Sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Venera Çerkini, me ftesë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe Departamentit të Shteteve të Bashkuara po qëndron për një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku është duke e përfaqësuar Republikën e Kosovës në takimet që po mbahen në Uashington DC në lidhje me projektin "Matja, ndërgjegjësimi dhe angazhimi i politikave për t'i përshpejtuar veprimet kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (Projekti MAP16)".

Në këto takime sekretarja Çerkini është e shoqëruar edhe nga përfaqësuesja e ILO-s, për Kosovë, Lindita Boshtrakaj. Gjatë prezantimit të saj, sekretarja Çerkini ka adresuar sfidat dhe arritjet në



implementimin e projektit MAP16, ku ka theksuar përpjekjet e vazhdueshme

institucionale për ndërtimin e kapaciteteve, përmirësimin, mësimin interaktiv dhe

zbatimin e praktikave të mira. "Qeveria e Kosovës ka krijuar politika dhe mekanizma për t'i

koordinuar përpjekjet e saj për ta trajtuar punën e fëmijëve. Krahas kësaj në vazhdimësi jemi duke u angazhuar që edhe përmes masave të ndryshme ta ndalojmë shfrytëzimin e fëmijëve në aktivitetet bujqësore dhe aktivitetet e tjera ekonomike që zhvillohen në zona rurale", ka thënë sekretarja Çerkini.

Pas prezantimeve në kuadër të këtyre takimeve, përfituesit e USDOL dhe palët e interesuara do të angazhohen në diskutime dhe do të ndajnë njohuri mbi atë që funksionon për ta forcuar kapacitetin për ta adresuar punën e fëmijëve, sfidat me të cilat përballen dhe përgjigjet e duhura ndaj këtyre sfidave.

MAP16 është një projekt bashkëpunimi zhvillimor i menaxhuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe financuar nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara.

## Richard Heater nga Ambasada Amerikane viziton ATK-në, njoftohet me përparimin në këtë institucion

PRISHTINË, 28 SHKURT - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka prituri në takim përfaqësuesin nga Ambasada Amerikane në Kosovë, Richard Heater, me të cilin kanë biseduar për progresin e ATK-së si dhe për bashkëpunimin e institucionit tatimor me Ambasadën.

ATK-ja ka njoftuar se bashkëpunimi ndërmjet ATK-së dhe Ambasadës së ShBA-së

është shumë i rëndësishëm për avancimin dhe zhvillimin e sistemit tatimor në Kosovë. "Me mbështetjen e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, Administrata Tatimore ka arritur përparim të rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe kapaciteteve të saj. Ambasada Amerikane ka ndihmuar në ofrimin e trajnimeve dhe programeve të specializuara për stafin e

Administratës Tatimore, duke kontribuar në rritjen e aftësive teknike dhe profesionale të punonjësve të saj. Përveç kësaj, mbështetja financiare dhe teknike i ka mundësuar Administratës Tatimore të zhvillojë dhe zbatojë projekte inovative për ta përmirësuar sistemin e mbledhjes së tatimeve dhe për ta luftuar evazionin fiskal", ka njoftuar ATK-ja.





# Luftë e re në prag? Transnistria i kërkon Putinit ndihmën ruse kundër Moldavisë



Rebelët pro-rusë në rajonin separatist të Transnistrias në Moldavi i kanë kërkuar këtë të mërkurë Rusisë "mbrojtje", mes frikës se territori i tyre mund të shëndërrohet në një pikë të re të nxehtë, ndikuar nga lufta e Moskës me Ukrainën fqinje.

Ripi i hollë i tokës që ndodhet në kufirin moldavo-ukrainas është de facto i kontrolluar nga forcat pro-ruse që nga rënia e Bashkimit Sovjetik, por njihet ndërkombëtarisht si pjesë e Moldavisë.

Në një kongres të posaçëm në rajon, i shtati në historinë e tij, ligjvënësit miratuan një rezolutë që i kërkon parlamentit rus të mbrojë Transnistrian përballë vetë Moldavisë.

Ata pretendojnë se qeveria moldave në Kishinau nisi një "luftë ekonomike" kundër Transnistrias, duke bllokuar importet jetike me qëllimin për ta kthyer atë në një "geto".

"Vendimet e kongresit aktual nuk mund të shpërfillen nga komuniteti ndërkombëtar", tha

në takim shefi i politikës së jashtme të republikës separatiste Vitaly Ignatiev.

Rezoluta e Transnistrias vjen vetëm një ditë përpara se presidenti Vladimir Putin të mbajë fjalimin vjetor në parlamentin rus.

Po kështu, thirrja për ndihmë nga Moska ka nxitur krahasimet me shkurtin e vitit 2022, kur

militantët e mbështetur nga Rusia në Ukrainën lindore kërkuan mbrojtje kundër atyre që i cilësuan sulme dhe granatime të pamëshirshme nga forcat ukrainase.

Delegatët në konferencë e përmendën pak Ukrainën, sipas rrëfimeve të sesionit në mediat shtetërore, duke e mbajtur fokusin te zemërimi i tyre ndaj

Moldavisë. Por, një zëdhënës i qeverisë moldave minimizoi shqetësimet përpara takimit.

"Nga Kishinau, gjërat duken të qeta... Nuk ka rrezik përshkallëzimi dhe destabilizimi të situatës në rajonin e Transnistrias. Kjo është një tjetër fushatë për të krijuar histori", tha zëdhënësi në një postim në Telegram.

Por, fakt është se që kur Moska nisi pushtimin e saj në shkallë të plotë të Ukrainës, Moldavia është shqetësuar se Kremli mund të përdorë Transnistrian për të hapur një front të ri në jugperëndim, pranë rajonit jugor të Ukrainës, Odesa.


Transnistria u trondit nga shpërthime të pashpjegueshme në vitin 2022, me analistët ushtarakë që spekulojnë se mund të ketë qenë një përpjekje e elementëve pro-rusë për të futur rajonin në konflikt.

Ndërkohë në mars, udhëheqja pro-ruse e Transnistrias akuzoi Kievin për një atentat ndaj liderit të tyre, një akuzë që Ukraina e hodhi poshtë. Dhe javën e kaluar, Ministria e Mbrojtjes e Rusisë pretendoi se Ukraina planifikoi një inkursion të armatosur në territorin e shkëputur, por pa dhënë asnjë provë konkrete.

Kremli ka rreth 1500 ushtarë të stacionuar në mënyrë të përhershme në këtë rrip toke, në të ashtëquajturin prej tyre si një mision "paqeruajtës".







## Karateistja që mposhti në finale serben: Ndjenjë e mirë për shkak të së kaluarës

PRISHTINË, 28 SHKURT - Karateistja e Kosovës, Alma Loki, është shprehur e lumtur me medaljen e artë në Kampionatin Ballkanit të mbajtur në Podgoricë në disiplinën kata. Loki theksoi se medalja është e veçantë për të, pasi në finale e mposhti serben Neda Millosheviq. “Në fakt, jam nisur me atë mendim që do të fitoj, që të bëhet kaq e madhe nuk ma ka marrë mendja. Ndoshta është bërë e madhe për shkak se në finale e kam mposhtur një kundërshtarë serbe, për atë

e kam pasur një përkrahje të madhe”, u shpreh Loki, e ftuar në “Klan Kosova”. Ajo potencoi se gara nuk ka qenë e lehtë pasi në të kanë marrë pjesë kundërshtarë të fortë. “Në sport nuk duhet pasur urrejtje. Është ndjenjë e mirë për shkak të së kaluarës që e kemi me Serbinë. Ndihehem mirë që e kam mposhtur, edhe që e kam mundur atë është tepër ndjenjë e mirë. Normalisht që ka vlerë dhe është shtysë për mua që të ushtroj më shumë”, ka shtuar Loki.



## Boksierët e Kosovës udhëtojnë drejt turneut kualifikues për Lojërat Olimpike

PRISHTINË, 28 SHKURT - Federata e Boksit e Kosovës ka njoftuar se boksierët e Kosovës, vëllezërit Shpetim dhe Bashkim Bajoku, do të udhëtojnë të enjten në Busto Arsizio të Italisë. Ata do të jenë të shoqëruar nga ushtruesi i detyrës së selektorit Musli Zymberi si dhe Latif Demolli, sekretar i përgjithshëm i Federatës së Boksit. Me anë të një njoftimi për medie bëhet me dije se ekipit do t'i bashkohet boksierja Donjeta

Sadiku dhe trajnerja Marjola Sallauka, të cilat janë në kamp në Asissi të Italisë. “Boksierët e përzgjedhur do të marrin pjesë në turneun e parë kualifikues botëror të boksit për Lojërat Olimpike ‘Paris 2024’. Turneu kualifikues do të mbahet nga data 02-11 mars 2024 në Busto Arsizio të Italisë. I urojmë fat dhe suksese ekipit tonë”, thuhet në njoftim e Federatës së Boksit.

## Prishtina, Penza, Bashkimi triumfojnë në Ligën Unike

PRISHTINË, 28 SHKURT - Prishtina ka vazhduar me formë të lartë në Liga Unike Femrat, pasi ka shënuar fitore ndaj Partizanit me rezultat 81:65 (19:14, 18:22, 18:13, 26:16) në javën e gjashtë. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, madje në minutën e tetë shifrat ishin 13:14, kur vendaset me një seri prej 6:0 e fituan çerekun e parë 19:14. Por, mysafiret u rikthyen shpejt dhe pjesa e parë ishte e barabartë, duke përfunduar 37:36. Por, pjesa e dytë ishte më e mirë për prishtinaset, që ngritën epërsinë me kalimin e minutave dhe triumfuan 81:65. Te Prishtina u dalluan Asiana Johnson me 25



pikë e pesë asistime, Jade Williams me 20 pikë e nëntë kërcime dhe Luna Castro me 11

pikë, nëntë kërcime e pesë asistime, ndërkohë te Partizani u dalluan Ornela Lalaj me tetë pikë

e 11 kërcime dhe Samra Omerbasiq me 15 pikë e shtatë kërcime. Prishtina ka pesë fitore e një humbje, kurse Partizani një fitore e pesë humbje. Penza ka shënuar fitore shumë të rëndësishme ndaj Tiranës me rezultat 89:68 (23:14, 25:24, 18:13, 23:17). Te Penza u dalluan Jones Nocole me 23 pikë e nëntë kërcime, Peevy Lucia Elise me 26 pikë e 14 kërcime dhe Saranda Daci me 18 pikë e 13 kërcime, derisa te Tirana u dalluan Morina Bojka me 20 pikë e 11 kërcime, Enisa Qosja me 17 pikë e katër kërcime dhe Klea Verri me 19 pikë. Tashmë të dyja skuadrat

kanë nga dy fitore e katër humbje. Bashkimi vazhdon të jetë i pamposhtur në Liga Unike Femrat. Skuadra prizrenase ka mundur Flamurtarin me rezultat 67:78 (13:23, 16:18, 24:21, 14:16). Më e dalluara te vendaset ishte Asia Henderson me 20 pikë e shtatë asistime, kurse te mysafiret u dalluan Adrienne Godbold me 23 pikë, Sarah Mgebeike me 20 pikë e nëntë kërcime dhe Arbnore Perquku me 10 pikë, tetë kërcime dhe 11 asistime. Flamurtari ka dy fitore dhe katër humbje, kurse Bashkimi gjashtë fitore në gjashtë ndeshje.

## Muriqi: Hapi i fundit për ta bërë një ëndërr realitet

MALLORCA, 28 SHKURT - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, ka shprehur lumturi për kualifikimin historik të Mallorcës në

finale të Copa del Rey. Muriqi realizoi një gol nga penalltia në duel me Real Sociedadin në ndeshjen e kthimit gjysmëfinale. Dy takimet përfunduan baras,

0-0 dhe 1-1 dhe kështu fituesi u përcaktua në 11 metra. “Ne nuk e mendojmë dhe nuk kemi frikë nga dështimi. Gjëja e vetme për të cilën

mendojmë është lavdia! Hapi i fundit për ta bërë një ëndërr realitet! Do ta arrijmë së bashku me ju!”, ka shkruar Muriqi në “Instagram”.





## Vidhet çanta që përmbante planin e sigurisë për Lojërat Olimpike

PARIS, 28 SHKURT - Një çantë që përmbante një kompjuter dhe dy memorie USB të cilat kishin planet e sigurisë së policisë për Lojërat Olimpike të Parisit është vjedhur në një tren në stacionin Gare du Nord të kryeqytetit francez. Çanta i

përkiste një inxhinieri nga Parisi, tha policia të martën, duke konfirmuar një raport nga televizioni BFM dhe duke shtuar se ai e kishte vendosur çantën në ndarjen e bagazhit mbi ulësen e tij. Inxhinieri ka thënë se laptopi i tij i punës

dhe dy USB përmbanin të dhëna të detajuara, veçanërisht planet e policisë bashkiake për sigurimin e Lojërave Olimpike verore të këtij viti. Dy mijë policë të komunës së Parisit dhe rreth 35 mijë personel sigurie do të

vendosen gjatë Lojërave Olimpike, të cilat zhvillohen nga 26 korriku deri më 11 gusht. Kryeqyteti francez ka qenë shpeshherë viktimë e sulmeve dhe për Lojërat Olimpike pritet të jetë një siguri jashtëzakonisht e madhe.



## Hamiltoni: As prindërve të mi nuk u thashë se kisha firmosur me Ferrarin

LONDËR, 28 SHKURT - Në vitin 2025 piloti britanik Lewis Hamilton do të pilotojë një Ferrari. Shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 do ta zërë vendin e spanjollit Carlos Sainz. Gjithsesi, deri më 1 janar 2025 ka ende kohë dhe Hamiltonin ka një tjetër mision këtë vit: të bëjë sa më mirë me Mercedesin.

Premtimi i Lewis Hamiltonit dhe Ferrarit për të mos menduar për vitin 2025, kur ulja e pilotit anglez të "kokëkuqja" do të bëhet konkrete, është fisnik dhe korrekt në qëllime. Kjo edhe në respekt të Carlos Sainzit dhe Mercedesit, por disi i vështirë për të ruajtur fushëveprimin e marrëveshjes. Kështu, shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 foli sërish për të ardhmen e tij, duke zbuluar një detaj kurioz: "Ishte zgjedhja ime personale, as prindërve nuk u thashë që do të shkoja te Ferrari. Doja ta bëja për veten time dhe ndjeva se duhej të gjeja se çfarë



ishte më e mira për mua".

Hamiltoni, duke folur për BBC-në, kujtoi ditët e marrëveshjes: "Gjithçka ndodhi shumë shpejt. Unë e njoh Vasseur për një kohë të gjatë. Isha i emocionuar nga ardhja e sezonit të ri, por nuk e dija se çfarë rezervonte e ardhmja për mua ose për sa kohë do të vazhdoj të garoj. Tani mund të

them se jam super i motivuar për të vazhduar".

39-vjeçari britanik, piloti me më shumë fitore në historinë e Formula 1, shpjegoi se si rasti i Ferrarit erdhi në kohën e duhur: "Nuk kisha shumë kohë për të menduar dhe ndoqa instinktet e mia, duke shfrytëzuar rastin".

## Bostoni dominon në NBA, triumfojnë edhe Golden State, Miami e Milwaukee

BOSTON, 28 SHKURT - Fitorja e nëntë radhazi për Bostonin në NBA, që mposhti me rezultat 117-99 Philadelphia, duke konsoliduar pozitat në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes. Browni me 31 pikë e Tatum me 29 pikë u dalluan për Celticsin, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e Maxey për miqtë. Pa probleme fitoi Milwaukee, që falë 47 pikëve të dyshes Antetokounmpo - Lillard, mposhti me rezultat 123-85 Charlotten. Jashtë fushës fitoi Miami, që mundi me rezultat 106-96 Portlandin, ndeshje me rivalitet, ku për miqtë u dallua



Butleri, autor i 22 pikëve. Minnesota mbron kreun e renditjes në Perëndim, pas fitores me rezultat 114-105 ndaj San Antonios. Edwardsi me 34 pikë bëri dallimin në fushë për vendasit. Të njëjtin ritëm ruan edhe Oklahomas, që mundi me rezultat 112-95 Houstonin, ndeshje ku u dallua Alexander Shai me 31 pikë.

Vijon momenti i mirë për Golden Staten, që falë 25 pikëve të Klay Thompsonit mundi me rezultat 123-112 Washingtonin. Fitore në sekondat e fundit arriti Clevelandi, që mundi me rezultat 121-119 Dallasin, me Mitchellin protagonist, autor i 31 pikëve, ndërsa 45 pikët e Donçiqit për teksanët nuk mjaftuan.

### REZULTATET

Cleveland - Dallas	121-119
Orlando - Brooklyn	108-81
Washington - Golden State	112-123
Atlanta - Utah Jazz	124-97
Boston - Philadelphia	117-99
New York - New Orleans	92-115
Chicago - Detroit	95-105
Milwaukee - Charlotte	123-85
Minnesota - San Antonio	114-105
Oklahoma - Houston	112-95
Portland - Miami	96-106

## Kloppi jep confirmimin, Thiago e ka mbyllur me Liverpoolin

Pas një mungese prej nëntë muajsh, Thiago Alcantara u rikthye në fushë për vetëm pesë minutat e fundit të humbjes kundër Arsenalit më 4 shkurt, por pësoi një tjetër

dëmtim muskolor, që e bëri sërish të padisponueshëm. Jurgen Klopp u pyet në një konferencë për shtypin nëse Thiago do të luajë sërish këtë sezon. "Nuk ka afate. Unë nuk e

di. Nuk është diçka afatshkurtër. Ai duhet të bëjë disa gjëra nga pikëpamja mjekësore dhe nuk e di nëse kjo do të thotë se ai do të jetë në gjendje të luajë përsëri këtë

sezon. Nuk mund të them asgjë më shumë", ka thënë Kloppi. Kontrata e mesfushorit spanjoll me "të kuqtë" përfundon verën e ardhshme dhe duke pasur parasysh dëmtimet e shumta

që ai ka pësuar që nga mbërritja në Liverpool (ka humbur në total 84 ndeshje zyrtare), Thiago mund të ketë luajtur ndeshjen e tij të fundit për ekipin në shkurt.

### SHKURT

#### Kosova U17 pëson humbje nga Islanda, rikthehet në Ligën B

Përfaqësuesja e Kosovës U17 në konkurrencën e vajzave ka pësuar humbje edhe në ndeshjen e tretë në kuadër të Grupit A2 për kualifikimet e Kampionatit Evropian "Suedia 2024". Të përzgjedhurat e Sanije Krasniqit, pas paraqitjes shumë të mirë kundër Portugalisë (0-1), e cila doli fituese e grupit dhe u kualifikua në Evropian, të martën kanë pësuar humbje të thellë ndaj Islandës, me shifrat 4-0, ballafaqim ky i cili vendosi se cila prej këtyre dy ekipeve do të bie në Ligën B për edicionin e ardhshëm kualifikues. Thelma Karen Palmadottir kaloi Islandën në epërsi në minutën e 11-të. Me shifrat 0-1 skuadrat shkuan në pushim, por në pjesën e dytë islandezet shfrytëzuan hapësirat e krijuara në mbrojtjen e Kosovës, e cila ishte në kërkim të golit të barazimit dhe, si rrjedhojë, shënoi edhe tre gola të tjerë. Ragnheibur Porunn Jonsdottir shënoi në minutën e 59 për 2-0, derisa më pas Hrefna Jonsdottir realizoi edhe dy gola të tjerë (76', 87') për rezultatin përfundimtar 4-0.

#### Bajrami rinovon me Benficën

Adrian Bajrami rinovon kontratën me klubin e njohur portugez Benfica.

Qendërmbrojtësi 21-vjeçar, pjesë e Benficës B që nga viti 2022, ka nënshkruar kontratën e re me kohëzgjatje deri në vitin 2026. I lindur në Zvicër dhe i formuar si futbollist në vendin helvet, Bajrami është grumbulluar në vitin 2022 nga Shqipëria dhe ka luajtur me fanellën kuqezi në tri miqësore: në humbjen 1-3 me Italinë, në fitoren 2-0 me Armeninë dhe në barazimin 0-0 me Estoninë. Me Benficën B këtë sezon është aktivizuar në 20 ndeshje dhe ka shënuar një gol.

#### Ronaldo dënohet me dy ndeshje moslojë

Sfidën në fushë e fitoi, por jo atë jashtë saj. Cristiano Ronaldo vazhdon ta pretendojë titullin në Arabinë Saudite dhe të jetë favoriti për Këpucën e Artë, veçse këto ambicie të tij morën një goditje. Superylli portugez do të duhet të rrijë pushim në dy ndeshjet e ardhshme të Ligës Profesioniste Arabe pasi u ndëshkua nga Komisioni i Disiplinës. Ronaldo mori edhe një gjobë, e gjithë kjo për shkak të veprimeve të tij në fushë në ndeshjen ku Al Nassri fitoi 3:2 ndaj Al Shababit. Ronaldo ofendoi dy herë tifozët vendas të cilët e tallën gjatë gjithë kohës me thirrje për Messin. Gjestet e CR7-s ishin vërtet të shëmtuara, e ai nuk mundi ta ruante gjakftohtësinë.

#### Bayerni në bisedime për transferimin e Theo Hernandezit

Bayern Muncheni ka nisur bisedimet për të nënshkruar me mbrojtësin e majtë të AC Milan, Theo Hernandez. "Bavarezët" e duan Hernandezin në vend të Alphonso Davies. Mediumi "Calciomercato.com" pretendon se Bayerni ka pasur bisedime me rethin e mbrojtësit për ta zbuluar disponueshmërinë e tij. Për momentin nuk ka asnjë çmim të kërkuar për Theon pasi kuqezinjtë duan ta mbajnë yllin e tyre në klub dhe së shpejti do të diskutojnë një zgjatje të mundshme të kontratës. Francezi ka katër gola dhe nëntë asistime në 33 paraqitje në të gjitha garat këtë sezon.



**NJOFTIM**


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BP Tax Consultants” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811587784 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BP Tax Consultants” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811587784 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability “BP Tax Consultants” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811587784 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Rilinda Qovanaj shpall te pavlefshme dëftesat ebkl VI- IX shfm " Leke Dukagjini " Prizren.

- Korab Qovanaj shpall te pavlefshme dëftesat ebkl VI - IX shfm " Leke Dukagjini" Prizren.

- Arbiana Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Hysen Rexhepi " Prizren.

- Dafina Kazazi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12.13 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Fitore Radi Bishtazhin KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X- të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fitore Radi nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën sh.f.m.u. "At Gjegj Fishta" Bishtazhin kk Gjakovë nga kl. VI-IX.

- Landi Palushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.12 të sh.m.Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

Albi Binaku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m.e. "Kadi Kusari" Gjakovë

Aeroporti Ndërkombëtare i Prishtinës-Kontrolli Ajror "Adem Jashari", Sh.A, shpall të humbur certifikatën e biznesit më numër: 70280980, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Marjana Nikolla nga Dobli Bare KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. "Dëshmorët Lleshi" Dobli Bare KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

